

Konferenca hapëse “Censi i Popullsisë dhe Banesave 2020”

Përshëndetje,

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj, Ju uroj mirëseardhjen në konferencën hapëse “Censi i Popullsisë dhe Banesave 2020, në Shqipëri”.

Nuk ka dyshim që Censi i Popullsisë dhe Banesave është aktiviteti statistikor më i rëndësishëm në vend dhe shtylla kryesore e sistemit kombëtar statistikor.

Censi i Popullsisë dhe Banesave është aktiviteti bazë për të hartuar politika të bazuara në shifra. Zhvillimi ekonomik i një vendi duhet të mbështetet në vendimmarrje të bazuar në të dhëna të sakta, të përditësuara dhe lehtësisht të aksesueshme, ndaj dhe prodhimi në kohë dhe me saktësi i statistikave është thelbësor.

Roli kryesor i tij është të prodhojë një numërim të saktë të popullsisë banuese të një vendi. Si i tillë, ai është procesi më i rëndësishëm demografik, me përdorim të lartë burimesh financiare dhe njerëzore.

Nëpërmjet Censit, do të grumbullohen të dhëna të rëndësishme nga të gjitha familjet në vend. Do të sigurohen informacione kryesore mbi popullsinë dhe banesat, do të shikohen ndryshimet e popullsisë në dekadën e fundit, madhësia dhe struktura e familjeve, migracioni, arsimi, punësimi, kushtet e banimit, etj. Seti i madh i të dhënave që do të sigurohen nga ky Cens, do të jenë një burim i mirë informacioni për zhvillimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave të ndryshme socio ekonomike, strategjive dhe planeve të zhvillimit në nivel kombëtar, lokal dhe sektorial. Gjithashtu, ato do të jenë dhe një burim i rëndësishëm për monitorimin e arritjeve të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, 2030.

INSTAT, ka angazhuar të gjitha resurset e tij dhe po i kushton vëmendjen maksimale këtij procesi statistikor, i cili kudo në botë, konsiderohet më i rëndësishmi në një shtet nga pikëpamja e llojit të informacionit statistikor që ai mbledh, pasi Censi është bazë për ndërtimin e një sistemi të shëndetshëm dhe të qëndrueshëm statistikor dhe politikbërës.

Dua të theksoj, që ky Cens është në përputhje të plotë me të gjitha standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga Kombet e Bashkuara dhe Bashkimi European.

Që ky Cens të jetë i suksesshëm dhe të arrijë objektivat e tij, duhet angazhimi i të gjithë aktorëve dhe partnerëve në vend. Ndaj dhe këtu gjej rastin të falenderoj qeverinë shqiptare e cila ka marrë angazhimin e saj për të mbështetur financiarisht censin e popullsisë dhe banesave. Mbështetje, pa të cilën ne nuk do ta mund ta kryejmë këtë aktivitet. Nga ana tjetër, një falenderim i vecantë shkon për Delegacionin European, i cili ka qënë dhe është gjithnjë pranë zhvillimit të statistikave në Shqipëri, duke ofruar mbështetjen e tij të pakursyer. Gjithashtu, falenderoj qeverinë suedeze dhe atë zviceriane, për një mbështetje të vazhdueshme të INSTAT në lidhje me censet e popullsisë dhe Banesave.

Një tjetër kontribues i rëndësishëm janë dhe organizatat e Kombeve të Bashkuara, UNDP, UNFPA, UNICEF, UN-women etj, të cilat gjithnjë kanë shprehur disponibilitetin e tyre për të bashkëpunuar me INSTAT.

Të nderuar Zonja dhe Zotërinj, dëshiroj të përfitoj nga kjo mundësi për të bërë me dije përkushtimin dhe profesionalizmin e të gjithë atyre që janë të përfshirë në këtë proces dhe që do të punojnë shumë gjatë muajve të ardhshëm për të siguruar që Cens 2020 të jetë një sukses.

Faleminderit!